



| | | | |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Prania / Dorezuar Prisje / Prisje Received / Delivered | 15-08-2022 | viti god year | 2 |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit | No Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPM/HU | 4750/2022 | | 1/3 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.655/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi–Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 655/2022 të datës 25.07.2022 të parashtruar nga ankuesja nga kundër Vendimit me numër:28/2022 të datës 14.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.08.2022, mori këtë;

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 655/2022 të datës 25.07.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 25.07.2022 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokollit 4277/2022, kundër Vendimit me numër 28/2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas të datës 14.06.2022 me pretendimet ankimore se refuzimi i aplikacionit nga njësia e pranimit dhe procedura e zhvilluar e rekrutimit për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Zyrën Rajonale në Ferizaj nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është në kundërshtim me dispozitat ligjore me kërkesën që të anulohet procedurat e rekrutimit

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia për Ndihmë Juridike Falas. Ndërsa

Këshilli me datë 05.08.2022, ka pranua nga Agjencia për Ndhim Juridike Falas, përgjigjen në kërkesë me numër protokoll: 4541/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 655/2022 të datës 25.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 17.06.2022; Vendimi A. Nr. 544/2022, i datës 27.06.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 23.06.2022; Vendimi i datës 21.04.2022, i Drejtoreshës Ekzekutive; Konkursi i datës 21.04.2022; Njoftimi i datës 09.06.2022; Ankesë e datës 13.06.2022, drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 14.06.2022, me numër protokoll 279-03-1; Vendimi i datës 01.02.2022,, i Drejtoreshës Ekzekutive; Vendimi i datës 07.12.2021; Vendimi i datës 23.10.2019; Përgjigje në ankesë e datës 05.08.2022, me numër protokoll 4541/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sikurse dhe analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.06.2022 ka nxjerr Vendimin A.nr.544/2022 me numër protokoll:3754/2022 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 17.06.2022 përmes të cilës ankesë ishte goditur Vendimit me numër:28/2022 i datës 14.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndhim Juridike Falas dhe po ashtu rezultoi se edhe sipas ankesës A.nr.655/2022 të datës 25.07.2022 goditet i njëjti akt administrativ në të njëjtën procedurë të rekrutimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në mbështetje të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"* Kolegji ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankueses A.nr.655/2022 të datës 25.07.2022 pasi që Këshilli ka vendosur paraprakisht me Vendimin A.nr.544/2022 të datës 27.06.2022 për të njëjtën qëllim, për të njëjtin objekt shqyrtimi dhe duke u bazuar mbi të njëjtën situatë faktike.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna në pasqyrimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.655/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Ndihme Juridike Falas;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Ndihme Juridike Falas;
- Arkivit të KPMSHCK-së